



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Legjislatura VI**  
**Sesioni pranveror**

---

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike

Mbledhja nr. 48

Prishtinë, më 18.06.2019, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-405

**P r o c e s v e r b a l**

**nga dëgjimi publik i komisionit për Projektligjin nr. 06/L-148 për Diasporën**

**Në dëgjim publik morën pjesë anëtarët e komisionit:** Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Glauk Konjufca, Elmi Reçica, Zafir Berisha dhe deputet nga komisionet e tjera: Korab Sejdiu dhe Ismajl Kurteshi.

**Munguan:** Fitore Pacolli, Dukagjin Gorani, Doruntinë Maloku-Kastrati, Evgjëni Thaçi-Drăgusha dhe Sergjan Mitrovic.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Agron Gashi, ZKM-ZL; Behar Isma, Ejup Kamberi, Shyhrete Gosalci, Burim Krasniqi, Qëndresa Fazliu, MDIS; Liza Gashi, Germin; Dijamant Zeqiri, diasporë Bajern; Blerta Aliu, KDI; Xhevat Isufi, mësues në Suedi; Agonis Thaçi, Vjeshtore Zeqiri, D+; Marigona Berisha, GP-LDK dhe media.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Minire Hasani.

**Dëgjimin e kryesoi:** Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e komisionit.

**Rendi i ditës:**

Dëgjim publik për Projektligjin nr. 06/L-148 për Diasporën

**Vjosa Osmani- Sadriu** fillimisht njoftoi se projektligji për diasporën është miratuar në parim më 30 maj 2019. Në këtë dëgjim çështjet të cilat do të duhej të debatoheshin e të cilat janë diskutuar edhe në komision, janë funksionimi i qendrave kulturore, përkrahja e mësimit dhe përparimit të gjuhës amtare të diasporës sonë dhe çështja e komunikimit me diasporën, në mënyrë më specifike nevojën për program televiziv për diasporën.

**Ejup Kamberi**, në mes tjerash, tha se motivi i nxjerrjes së ligjit të ri ka qenë statusi i paqartë i qendrave kulturore, si dhe ristrukturimi i ligjit të kaluar lidhur me proceset e zhvillimit ekonomike të vendit dhe koordinimet e ndryshme në procesin e organizimit të mësimit plotësues për diasporën.

**Time Kadrijaj** theksoi se gjatë debateve publike të Projektligjit në diasporë, kanë marrë pjesë dhe kanë evidentuar kërkesat e diasporës dhe se do të punojnë seriozisht për të nxjerrë një ligj të implementueshëm në mënyrë që kërkesat e diasporës të inkorporohen në këtë projektligj.

**Xhevat Isufi** tha se është mësues në Suedi, ku arsimon 160 nxënës në qytetin e Egelholmit. Theksoi se me krijimin e Ministrisë së Diasporës i është kthyer dinjiteti mërgatës sepse ka bërë organizime të shumta me diasporën. Sa i përket projektligjit e gëzon fakti që parashihet financimi për mësimin në gjuhën shqipe, e po ashtu edhe mundësia e televizionit për diasporën ku do të reflektohej aktiviteti i gjithë diasporës.

**Liza Gashi**, nga organizata Germin, organizatë joqeveritare që fokus kryesor e ka diasporën shqiptare dha komentet e saja lidhur me projektligjin dhe njoftoi se sugjerimet e tyre për projektligjin do t'i përcjellë me shkrim.

**Glauk Konjufca**, në diskutimin e tij lidhur me ruajtjen e kulturës dhe gjuhës, tha se do të propozon amendament që koston e shpenzimeve të arsimit në diasporë ta bartë shteti i Kosovës, në vendet ku nuk financohet arsimi për diasporën.

**Korab Sejdiu** tha se çështja e votimit për zgjedhjet e përgjithshme nga diaspora është adresuar sa ka pasur mundësi në Komisionin për Legjislacion.

**Elmi Reçica**, ritheksoi çështjen e organizimit të diasporës si bashkësi shqiptare, sepse një organizim i tillë e ka mundësinë e ndikimit edhe në shtetin ku jeton diaspora, por edhe në shtete prej nga vijnë ata. Një gjë e tillë tha se tani për tani është e pamundur për shkak të implikimeve shumë të mëdha.

**Zafir Berisha**, në mes tjerash, tha se, përfaqësimi politik i drejtë për drejtë i diasporës për momentin është i pamundur, por ajo që duhet të jetë primare për ne, është mundësia që njerëzit tanë në diasporë të mund të votojnë të përzgjedhin atë që mendojnë se i përfaqëson edhe interesat e diasporës.

**Danush Ademi** njoftoi se të gjithë qytetarët e komunitetit ashkali mbi 150 mijë që janë në diasporë mësojnë gjuhën shqipe dhe flasin shqip.

**Vjosa Osmani** njoftoi të pranishmit se lidhur me projektligjin, komisionit i janë adresuar disa komente sipas të cilave disa nene duhet t'i referohen Ligjit për përdorimin e gjuhëve zyrtare në Kosovë.

**Dijamant Zeqiri**, mërgimtar në Bajerni, pyeti se si qëndron puna me polisat e sigurimit, sepse siç theksoi ai kanë barriera dhe pritje të gjata në Merdar, gjatë udhëtimit për në vendlindje. Ai po ashtu pyeti se a do të ketë lehtësira për investitorët me ligjin e ri, pasi që është i interesuar në këtë drejtim.

**Ismail Kurteshi** tha se do të angazhohet që si pikë e rendit të ditës në njërën nga mbledhjet e Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini e Sport, ta kenë çështjen e këtij ligji dhe sidomos pjesën që ka të bëjë me organizimin e aktiviteteve kulturore përmes qendrave kulturore dhe me

mësimin shtesë që është obligim i dy ministrive, i Ministrisë së Diasporës, dhe Ministrisë së Arsimit.

**Time Kadrijaj** tha se kemi pasur debat parlamentar në Kuvend për policat e sigurimit të cilat jemi munduar t'i heqim, por për shkak të rrethanave politike nuk kemi mund t'i heqim, por këto polica mërgimtarët mund t'i paguajnë online që të mos paraqesin vonës në rrugë. Sa i përket përfshirjes së diasporës në zgjedhje tha se s'mund të kemi përfaqësim të rezervuar për shkak se duhet pasur ndryshime në Kushtetutë, por partitë politike mund të kenë në garë të zgjedhur një përfaqësues të diasporës dhe ai mund të përkrahet dhe të votohet.

**Ejup Kamberi** njoftoi se vitin e kaluar MDIS ka përlogaritur koston financiare për ta mbështetur financiarisht organizimin e mësimi plotësues, e cila është dashur të pezullohet për shkak të koston së lartë financiare. Tha se MDIS është duke punuar në zgjidhjen e çështjes së organizimit të mësimi plotësues. Sa i përket Kartonit të Gjellbër njoftoi se kjo çështje nuk është e natyrës së këtij projektligji, dhe se do të trajtohet me një akt tjetër normativ. Duke iu referuar fjalimit të deputetit Ismajl Kurteshi njoftoi se MDIS së bashku me Ministrinë e Arsimit të Kosovës dhe të Shqipërisë kanë shpërndarë librat e gjuhës shqipe në çdo vend ku mësimi plotësues është i organizuar.

**Shyhrete Gosalci** njoftoi se të gjithë librat shkencor që mësohen në Kosovë, si dhe lekturat shkollore prej klasës së parë deri te klasa e nëntë janë shpërndarë në diasporë. Ajo po ashtu njoftoi se edhe botimi i Adem Demaçit është shpërndarë në diasporë.

**Xhevat Isufi** shprehu mirënjohjen për MDIS dhe MASHT për krijimin e kushteve më të volitshme për mundësinë e zhvillimit të mësimi të gjuhës shqipe në diasporë. Njoftoi se ueb faqet zyrtare të MDIS dhe MASHT janë publikuar 19 tekste mësimore të nivelit evropian të përshtatshme për mësimin e gjuhës amtare në diasporë. Kërkoj që të harmonizohen ligjet në mënyrë që të mundësohet financimi i mësimi shqip në diasporë.

**Vjosa Osmani Sadriu** tha se të gjithë jemi dakord që të financohet mësimi plotësues në diasporë.

**Korab Sejdiu**, lidhur me Kartonin e Gjellbër, tha se MDIS duhet të bashkëpunojë me Ministrinë e Financave dhe me Ministrinë e Punëve të Jashtme në mënyrë që të iniciohet hartimi i marrëveshjeve bilaterale me shtete individuale që të trajtohet çështja e Kartoni të Gjellbër. Ai njoftoi se çështja e votimit jashtë vendit, çështja e Kartonit të Gjellbër dhe arsimit shqip jashtë vendit janë çështje që janë përmendur në çdo takim të tij me pjesëtarët e diasporës.

**Liza Gashi**, një nga arsyet se pse po ndryshohet ky ligj, tha se është fakti që ka kompetenca të përziera në mes të Ministrisë së Kulturës dhe asaj të Diasporës! Këto kompetenca tha se duhet të harmonizohen dhe koordinohen. Ajo tha se është e rëndësishme që të garantohet mësimi plotësues jashtë vendit, si dhe të fillohet të mendohet për ngritjen e kuadrove të reja, pasi që 80% e mësuesve jashtë vendit janë duke u pensionuar. Element tjetër i rëndësishëm i këtij projektligji tha se janë qendrat kulturore dhe se në këtë drejtim duhet të mendohet për një kohë më afatgjate se cili është kapaciteti ynë dhe sa kemi mundësi avancimin e këtyre qendrave. Sa i përket çështjes së Kartonit të Gjellbër tha pajtohet me deputetin Sejdiu, dhe se duhet një

bashkëpunim me shtetet kyçe siç janë Gjermania, Zvicra, Austria dhe pastaj edhe me vendet tjera. Ajo tha se është e rëndësishme që të krijohet një nen i posaçëm në projektligj për kthimin e bashkatdhetarëve në Kosovë. Sa i përket regjistrimit të diasporës njoftoi se ai regjistër i ka rreth 350 mijë kontakte dhe shprehu mendimin se ai regjistër duhet të vendoset në shërbim të programeve që ministria i kërkon.

**Elmi Reçica** tha se është shumë e rëndësishme që të mbikëqyret zbatimin e këtij ligji, nëse arrihet që me plotësimet që u thanë këtu projektligji të shndërrohet në ligj. Sa i përket kthimit të diasporës në Kosovë tha se ne kemi një Ministri për Kthim dhe se do të ishte i mirëseardhur një ligj për kthimin e diasporës në Kosovë. Ai ritheksoi se njerëzit që jetojnë në diasporë duhet të kyçen në jetën politike të vendit përkatës.

**Behar Isma**, lidhur me çështjen Kartonit të Gjelbër, njoftoi se një prej sfidave kryesore është se marrëveshjet bilaterale nuk ndodhin shtet me shtet, por ato ndodhin nëpërmjet byrove. MDIS tha se është përprekur ta luajë rolin e fasilituesit të këtij procesi, por për shkak të pamundësive ose mos gatishmërive të byrove tjera që të bëhet kjo çështje nuk është realizuar. Ai më tej njoftoi se statusi i Byrosë Ndërkombëtare të Sigurimeve parasheh që shtetet për tu bërë anëtarë në këtë organizatë duhet të jenë anëtarë të Kombeve të Bashkuara.

**Ismaj Kurteshi** tha se me idetë që u shprehen në këtë dëgjim publik, por edhe të tjerëve mund të bëhet një ligj i cili do t'iu shërbente bashkatdhetarëve në jetën e tyre. Çështje e rëndësishme tha se është mos asimilimi i gjeneratës së dytë dhe të tretë dhe se duhet të bëhet shumë në këtë drejtim. Ai njoftoi se është duke u punuar në angazhimin e rinisë në diasporë, se janë duke u hartuar disa programe në mënyrë që të bashkëpunojë rinia e diasporës me rininë që është në Kosovë.

**Vjosa Osmani Sadriu**, në fund të dëgjimit publik, kërkoi nga pjesëmarrësit që vërejtjet, sugjerimet që ndërlidhen me projektligjin t'i dorëzohen Administratës së Komisionit. Ajo po ashtu bëri të ditur se do të bashkëpunohet edhe gjatë fazës së amendamentimit të këtij projektligji.

Diskutimet e plota janë pjesë e transkriptit nga dëgjimi.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

Kryetarja e komisionit,

---

Vjosa Osmani-Sadriu

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit